



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimë / Dorezuar / Prilijeno / Protato / Received / Deliverty	05.12.2022	2	viti / god / year
Organ / Rjeshtja / Organ / Jedinstvo / Org. / Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No	Shtetjorja / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKMESHCK	7678/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.933/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehemti dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.933/2022 të datës 20.10.2022 e parashtruar përmes postes elektronike ankesa.kpmsk@rks-gov.net nga ankuesi kundër Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numer A.nr.933/2022 e datës 20.10.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi** Vendimi i datës 30.09.2022 i Kryesuesit të Komisionit Vlerësues për Levizje Brenda Kategorise të Komunës së Prishtinës.

Arsyetim

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", me numër reference RN00009398 i shpallur sippas njoftimit të datës 12.07.2022 për afatin për aplikim nga data 27.07.2022 i datës 03.08.2022.

Spektori i Burimeve Njerëzore në kuadër të Komunës së Prishtinës me datë 16.09.2022 ka nxjerr Njoftim për anulim të konkursit të datës 26.09.2022 për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", me numër reference RN00009398 të datës 12.07.2022 për lëvizje brenda kategorisë, me arsyetimin se asnjë nga kandidatet nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për përzgjedhje.

Kundër Njoftimit për anulim të konkursit , ankuesi me datë 27.09.2022 ka parashtruar ankesë te Komisioni Përzgjedhës në Komunën e Prishtinës me pretendimin ankimor se vlerësimi nuk ka qenë i drejtë. Njësia e Burimeve Njerëzore me datën 30.09.2022 nxjerrë Vendimin me të cilin ankuesit i ka refuzuar ankesën si të pa bazuar për pozitë "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim".

I pakënaqur me vendimet e datës 30.09.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, ankuesi me datën 20.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 65331/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 28.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit me datë 18.11.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokolli 7229/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës me provat shtese përmes e-mailit zyrtar të datës 02.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6331/2022 e datës 20.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postes elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, me datën 20.10.2022; Njoftim i datës 12.08.2022 nga zv.Menaxher i personelit; Njoftim i datës 13.09.2022 nga Menaxheri i personelit; E-mail i datës 16.09.2022; Njoftim i datës 26.09.2022 zv.Menaxher i personelit; Ankesë e datës 27.09.2022 nga ankuesi; E-mail i datës 17.10.2022 nga SIMBNJ për ankuesin; Vendim i datës 30.09.2022 nga komisioni i ankesave; Përgjigje në ankesë e datës 18.11.2022 me nr.protokolli 7229/2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 19.09.2022; Konkursi i datës 12.07.2022; Aplikacioni i z. me dokumentacionin e bashkëngjitur, Letërnyoftimi, Diplomë nr. 3666 e datës 01.11.2013 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina-Fakulteti Ekonomik 180 ECTS; Diplomë e Masterit e datës 14.04.2016 nr.878, e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", me titullin master për banka financa dhe kontabilitet; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 25.02.2022; Formuari i datës 19.08.2021 për punën provuese duke filluar nga data 15.10.2020; mirenjohje e datës 06.12.2021 nga Komuna e Prishtinës; Akt emërimi i datës 23.08.2021; Aplikacioni i ankuesit, me dokumentacionin e bashkëngjitur, Letërnyoftimi i ankuesit, Diplomë e Shkollës së mesme të lartë - Gjimnazi në Prishtinë; Diplomë nr.103/13 e datës 28.02.2013 e lëshuar nga Kolegji AAB-Programi Bachelor banka financa kontabilitet me 180 ECTS; Certifikatë e datës 06.05.2012, lëshuar nga Globus; Certifikatë e datës 4.12.2020 lëshuar nga INDEP; Certifikatë e UNDP; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 17.01.2022; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.12.2020; Vërtetim i datës 06.04.2022 lëshuar nga Komuna e Podujevës; Vërtetim i datës 06.04.2022 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga sistemi informativ i Policia e Kosovës; Certifikatë nr. 1864/2022 e datës 05.04.2022 e nxjerrë nga Gjykata Themelore dega në Podujevë , për gjendjen e evidencës penale; Certifikatë e 2020 lëshuar nga HELP; Certifikatë e datës 02.10.2019 lëshuar nga IKAP; Reference e datës 05.09.2013; Akt emërim i datës 01.03.2019; Akt emërim i datës 02.03.2020; Vërtetim nr, 13-75/2022 i datës 06.04.2022 dhe me numër 13-74/2022 i datës 06.04.2022; Kërkesës se datës 30.11.2022 për mes e-mailit zyrtar; Përgjigje e datës 01.12.2022, Vendimi i datës 14.09.2022 për themelimin e komisionit për pranim në lëvizje brenda kategorisë; Akt emërimi i datës 10.03.2017 për znj. Akt emërimi i datës 01.03.2022 për z. Akt emërimi i

datës 01.03.2022 për znj. Akt emërimi i datës 11.11.2019 për z. Akt emërim i datës 01.12.2021 për znj. Vendim i datës 06.09.2022 për znj. për caktiminë pozitë" Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim i Kontratave"; Njoftim i datës 02.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 29.06.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për *lëvizje brenda kategorisë* për pozitën e punës "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", me numër reference RN00009398, në Komunën e Prishtinës, Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 27.07.2022 deri me datë 03.08.2022, dhe si kritere të përgjithshme formale, kanë qenë të përcaktuara:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e studimeve Universitare më të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;*
- *Kualifikime të poqëm formale: Fakulteti Ekonomik, Administrim publik,*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy(2)vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Sipas shkresave të lëndës është konstatuar se në konkursin me numër referencë RN00009398 për pozitën „Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim“, e shpallur nga Komuna e Prishtinës, dy kandidatë, janë vlerësuar se i plotësojnë kriteret e konkursit e në këtë rast edhe ankuesi sipas njoftimit të datës 12.08.2022, ndërsa me datën 16.09.2022 është njoftuar individualisht përmes emailit, se ka plotësuar kriteret për listën e shkurte dhe është ftuar për intervistë me gojë me datën 19.09.2022, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se verifikimi paraprak për kandidatet që kanë plotësuar kushtet e konkursit është vlerësim i drejtë, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës ka vepruar në pajtim me kompetencën e tij të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin".

Sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi pas procedurës së intervistës e cila është mbajtur me datën 19.09.2022 për pozitën Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim" nga intervista me gojë ka arritur ti grumbulloje vetëm 28 pikë, respektivisht nuk ka arritur të grumbulloje të paktën 60 pikë të mjaftueshme, për tu përzgjedhur si kandidat i suksesshme për pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa", andaj mbi këtë fakt Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës me rastin e publikimit të Njoftimit të datës 26.09.2022 për anulimin e konkursit për pozitën " Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", sepse asnjëri nga kandidatet nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për përzgjedhje gjegjësisht lista përfundimtare është pa fitues, ka vepruar në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se:" 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues".



Kundër njoftimit të datës 26.09.2022 ankuesi me datën 27.09.2022 ka parashtruar ankesë për Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Komunës së Prishtinës i cili pretendon që të bëhet anulimi i njoftimit të datës 26.09.2022 dhe të përzgjidhet për pozitën „Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim“ në Komunën e Prishtinës, ndërsa Komisioni i Vlerësimit me datë 30.09.2022 nxjerr Vendim me cilin e refuzon ankesën e ankuesit të datës 27.09.2022, duke theksuar se Komisioni me rastin e vlerësimit të kandidatëve ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe me nenin 47 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe gjitha së bashku dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesi posedon Diplomë me numer Nr.103/13 të datës 28.02.2013 të leshuar nga Kolegji AAB me të cilën deshmohet se ka përfunduar studimet themelore universitare në programin Banka Financa dhe Kontabilitet me datë 09.02.2013 dhe ka marrë titullin Bachelor (BA) në Banka, Financa dhe Kontabilitet, me gjithsej 180 kredi/ECTS, si dhe me përvojë pune si në vijim : Vërtetimin e datës 06.04.2022 të leshuar nga Komuna e Podujevës, me të cilin deshmohet se ka punuar prej datës 01.03.2019- vazhdon në Komunën e Podujevës sipas Akt emërimit të datës 01.03.2019 në pozitën „Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve“.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji vlerëson se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 27.07.2022 deri më datën 03.08.2022 i ka plotësuar kriteret e konkursit por nuk ka marrë pikët e mjaftueshme për përzgjedhje në pozitën e shpallur në konkursin e datës 12.07.2022, kështu që organi i punësimit Komuna e Prishtinës me rastin e anulimit të konkursit të shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës “Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim”, me numër reference RN00009398 sipas njoftimit të datës 26.09.2022 ka vepruar konform dispozitave të nenit 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se “3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”. Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore, me rastin e publikimit të njoftimit të datës 26.09.2022 për anulimin e konkursit të shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës “Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim”, me numër reference RN00009398, ka vërtetuar drejte dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publikë, dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komisioni me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 30.09.2022 sipas ankesës së ankuesit të datës 27.09.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 47 dhe 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 12.07.2022 për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00009398 për pozitën "Zyrtar për Planifikim dhe Zhvillim", me afatin për aplikim nga data 27.07.2022 deri me datë 03.08.2022, është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 40 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.933/2022.

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse



Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

